



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201400741/2

Tiranë ____/____/2014

Lënda: *Rekomandim për nxjerrjen e Udhëzimit përkatës në zbatim të nenit 11 të VKM-së Nr.404 datë 20.06.2012 "Për përcaktimin e masës së kriterëve të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar nga personat me statusin e të verbërit dhe invalidit paraplegjik e tetraplegjik për faturat e energjisë elektrike e telefonisë fikse".*

Drejtuar: **Z. Erjon VELIAJ**
Ministër i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë

TIRANË

I nderuar zoti Ministër,

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur ankesa nga shtetas të ndryshëm, të cilët gëzojnë statusin e të verbërit dhe invalidit paraplegjik e tetraplegjik dhe banojnë si qiramarrës.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj si dhe në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, ka vendosur pranimin e ankesave dhe shqyrtimin e tyre.

Nga shqyrtimi i ankesave, kemi konstatuar se persona që gëzojnë statusin e të verbërit dhe atij paraplegjik e tetraplegjik, të cilët jetojnë në banesa me qera, nuk përfitojnë nga kompensimi financiar për faturat e energjisë elektrike dhe telefonisë fikse, pavarësisht se ligjërisht janë përfitues të atyre kompensimeve.

Nga korrespondenca që kemi patur me njësitë e qeverisjes vendore, jemi informuar se Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.404 datë 20.06.2012 “Për përcaktimin e masës së kriterëve të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar nga personat me statusin e të verbërit dhe invalidit paraplegjik e tetraplegjik për faturat e energjisë elektrike e telefonisë fikse”, nuk është shoqëruar me udhëzimin përkatës. Pagesat janë bërë vetëm për kryefamiljarët sipas Formularit Mod-1, programi i fondeve për pagesat e aftësisë së kufizuar.

Në dipozitat e këtij vendimi janë përcaktuar masat dhe kriteret e përfitimit të kompensimeve përkatëse për invalidët përfitues. Por duke mos patur një akt nënligjor specifik në zbatim të atij vendimi, ai nuk gjen zbatim për kategorinë e personave qiramarrës.

Duhet rregulluar situata e kësaj kategorie, me qëllim që të mos ndihen të diskriminuar nga personat e tjerë që nuk jetojnë në banesa me qera, të cilët e përfitojnë këtë të drejtë. Edhe qëllimi i Konventës së OKB-së “Për mbrojtjen e të drejtave për personat me aftësi të kufizuar”, është të nxisë, mbrojë dhe të sigurohet që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre,

Në pikën 11 të VKM-së Nr.404 datë 20.06.2012, thuhet shprehimisht se:
“Ngarkohet Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të nxjerrë udhëzimin përkatës të këtij vendimi”

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës, ku thuhet shprehimisht se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive ë njeriut nga administrata publike”, dhe në vijim të nenit 21/b ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË:

Nxjerrjen e Udhëzimit përkatës në zbatim të nenit 11 të Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.404 datë 20.06.2012 “Për përcaktimin e masës së kriterëve të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar nga personat me statusin e të verbërit dhe invalidit paraplegjik e tetraplegjik për faturat e energjisë elektrike e telefonisë fikse”, me qëllim që të mundësohen përfitimet edhe për kategorinë e invalidëve që jetojnë në banesa me qera.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se;

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj,

Me respekt

AVOKATI I POPULLIT

IGLI TOTOZANI